



Raporti vjetor
Annual report
2015





SIGAL Business Center, Tiranë, Shqipëri

UNIQA Tower, Vjenë, Austri

PËRMBLEDHJE

Contents



SIGAL UNIQA pjesë e samitit për Naftën, Gazin dhe Energjinë Fq. 14

Sigal UNIQA part of the summit for oil, gas and energy Page 14



SIGAL UNIQA vlerësohet nga Qeveria Shqiptare për kontributin në kulturë...Fq. 16

Sigal UNIQA was estimated by the Albanian Government for his contribution to culture....Page 16



Lider i tregut të sigurimeve Fq. 26

Leader of the insurance market Page 26

Grup Rajonal Sigurimesh / Regional Insurance Group	05
Fjala përshëndetëse / Forewards	06
CEO i UNIQA Insurance Group / CEO of UNIQA Insurance Group	
CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA / CEO of SIGAL UNIQA Group AUSTRIA	
Vlerat dhe Parimet / Our values and principles	12
Aksionerët tanë / Our shareholders	13
Ngjarje të rëndësishme / Important events	14
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA pjesë e Samitit për Naftën, Gazin dhe Energjinë	
Liga Ballkanike e Basketbollit nën emrin e SIGAL UNIQA	
Ekspozita UNIQA'Art	
Takimi informues me mediat 'Të flasim për sigurimet'	
SIGAL UNIQA mbështet sipërmarrjen 'Startup Grind Albania'	
SIGAL UNIQA vlerësohet nga Qeveria Shqiptare për kontributin në kulturë	
Vlerësime ndërkombëtare për SIGAL UNIQA	
Përgjegjësia jonë sociale / Our Social Responsibility	19
Skuadra SIGAL UNIQA / SIGAL UNIQA Team.....	21
Fushata e re "Mendo" / New Advertisement Campaign "Think"	22
Të dhëna financiare / Financial data	25
Tregu rajonal i sigurimeve / Regional Insurance Market	26
Raporti i auditit / Audit Report	30

GRUP RAJONAL SIGURIMESH

Regional Insurance Group



Volumi i primeve (Euro)

Premium volum

Group	58,335,782
AL	32,917,888
KS	13,393,170
MK	12,024,724

Nr. i kontratave

Nr. of contracts

Group	764,991
AL	256,264
KS	133,708
MK	375,019

Nr. i zyrave

Nr. of offices

Group	419
AL	230
KS	66
MK	123

Agjentë dhe punonjës

Agents and employees

Group	1,583
AL	856
KS	266
MK	461



Andreas Brandstetter
CEO, UNIQA Insurance Group
Kryetar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA

Të dashur aksionerë,

Viti 2015 ishte sërish viti më i suksesshëm në historinë e kompanisë tonë. Por kjo nuk na bën që ta shohim si një arsye për tu kënaqur paraprakisht, por si një mundësi për të rritur falëndërimet tona ndaj jush si aksionerë për besnikërinë tuaj, si dhe për të gjithë punonjësit për kontributin e madh që ata kanë dhënë në arritjen e këtij suksesi.

Është koha që secilit prej jush, ti japim meritat që i takojnë për punën e bërë përgjatë 5 viteve të kaluara.

Pesë vite më parë, në verë të vitit 2011 ne ju prezantuam për herë të parë programin tonë afatgjatë "UNIQA 2.0.", i cili ishte programuar që të zgjasë deri në vitin 2020:

- Cili është qëllimi ynë? Të dyfishojmë numrin e klientëve në 15 milionë.
- Si do ta arrijmë qëllimin? Duke u fokusuar në kompetencat kryesore si një sigurues i parë në dy tregjet tona kryesore, Austri dhe Europën Qendrore-Lindore (CEE).
- Ku duam të përmirësohemi? Tek UNIQA Austria në fitime, tek Raiffeisen Insurance në produktivitet, tek UNIQA International në termat e rritjes së fitimit, në tregjet ekzistuese dhe përreth Grupit-nga pikëpamja e programit "Solvency II"- në profilin e riskut dhe të rikthimit.
- Çfarë kërkon kjo strategji? Një rritje të investimit të kapitalit të mbetur stok dhe një strukturë e korporatës, e cila të sjell në mend nevojat e tregut të kapitalit.
- Përse është fitimprurëse kjo për aksionerët tanë? Sepse ne duam të rrisim fitimin para taksave: nga përreth 145 milionë Euro që ishte në vitin 2010 në 400 milionë në 2015-ën.

Punë e vështirë – Shumë objektiva të arritur

Më shumë se gjysma e programit "UNIQA 2.0" është lançuar dhe zbatuar dhe ne të gjithë së bashku, si një skuadër e madhe me më shumë se 21 mijë punonjës dhe partnerë kemi arritur, përmes punës së vështirë, shumicën e objektivave që i vendosëm vetes në vitin 2011.

Përgjatë pesë viteve të kaluara, fokusi ynë si sigurues i

parë në dy tregjet kryesore, Austri dhe shtetet e Evropës Lindore-Qendrore është bërë shumë herë më i dukshëm dhe ju si aksionerë keni pasur mundësinë që ta ndiqni këtë zhvillim, edhe pse investimet nuk kanë qenë në përputhje me strategjinë tonë.

Unë besoj në të vërtetë se në pesë vitet e kaluara ne jemi bërë shumë herë më të hapur, më të orinetuar drejt performancës, më të mirë dhe më të shpejtë dhe kjo është edhe për faktin se kemi afruar pranë kompanisë tonë të rinj të talentuar. Nga ana tjetër, unë jam i sigurtë se ka akoma shumë vend për tu përmirësuar në të gjitha fushat.

Pjesa e dytë e programit-Sfida të mëdha

Nga njëra anë, situata ekonomike jo e mirë në tregjet e kapitalit me normë të ulët interesi, e cila ka qenë historikisht dhe që rezulton të ketë efekt ekstremisht negativ në modelin e bizneseve tradicionale dhe në të ardhurat në investime, paraqet sfidën më të madhe në "ekonominë e vjetër", në modelin ekzistues të biznesit. Në shtesë të kësaj, do të na duhet gjithashtu të shtojmë volumin e shpenzimeve që rezultojnë si pasojë e rritjes së numrit të rregulloreve. Po ashtu ne presim një rritje të normës të një rritjeje ekonomike të moderuar në kohën që jemi. Pyetja që shtrohet përpara kësaj situatë është: Si po reagojmë ndaj një situatë të tillë?

Nga ana tjetër, ndërsa presim "krahë të fuqishëm" nga jashtë, po përballemi edhe me një ndryshim të madh të pritshmërive të klientëve dhe të nevojave të tyre.

Historia me industrinë e tjera ka treguar se gjithëprezenca e dixhitalizimit në të gjitha fushat e jetës është e aftë të eliminojë ose më së paku ti reduktojë modelet e biznesit në një model përçarës dhe brutal dhe me një shpejtësi

marramendëse, në të cilën pjesëmarrësit insuficientë që nuk janë të shkathët mjaftueshëm mund të mbeten prapa.

Ky trend ka prekur edhe sektorin e sigurimeve dhe nuk ka për të ndaluar, ndaj ne po përgatitemi me një fokus të lartë për ti paraprirë këtij trendi të ri.

Investimi në Dixhitalizim

Ne besojmë se do ti shohim këto sfida të reja jo si ushtrime të detyrueshme të një mode të copëtuar, por do ti përqafojmë ato si mundësi të mëdha për ne që duhen shfrytëzuar. E vetmja mënyrë për ta bërë këtë është që ta shndërrojmë biznesin tonë nga një ofrues i produkteve të sigurimit, në ofrues të shërbimeve të integruara, i cili arrin tek klientët kudo që ndodhen në "mjedisin e tyre të nevojave", ku ata intuitivisht presin siguri dhe shërbime.

Në mënyrë paralele me këtë, ne kemi lançuar programin më të ri dhe më të madh në historinë tonë dhe do të investojmë një shumë totale prej 500 milionë Eurosh deri në vitin 2020. I gjithë ky investim, një pjesë e të cilit do të fillojë të investohet që në vitin 2016, do të bëhen me qëllim "ri-dizajnimin" e modelit tonë të biznesit. Në emër të të gjithë Bordit Menaxhues, do doja t'ju falëndëroja të gjithëve ju zonja dhe zotërinj për angazhimin tuaj tek UNIQA. Ju siguroj se do ta rrisim zhvillimin e UNIQA-s tonë dhe tuajën, me një entuziasëm personal, me konsekuencë dhe me ekspertizë në sipërmarrje. Ne do të vazhdojmë të fokusohemi në përmbushjen e pritshmërive tuaja, duke mbetur të denjë për besimin tuaj.

Sinqerisht,
Andreas Brandstetter
CEO, UNIQA Group



Avni Ponari
CEO
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Të dashur klientë dhe partnerë të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA,

Para së gjithash dëshiroj t'ju falënderoj për një tjetër vit bashkëpunimi të frytshëm të shtuar në shportën tonë të marrëdhënieve disa-vjeçare. Një falënderimi i përzemërt shkon për të gjithë Ju klientë të SIGAL UNIQA që na keni besuar astetet tuaja me vlerë, përfshirë këtu edhe gjënë më të çmuar: Jetën.

Pavarësisht sfidave dhe vështirësive të veta, viti 2015 ishte i mbarë për grupin rajonal SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA duke arritur një volum primesh prej rreth 58 milionë Eurosh (14% më shumë se një vit më parë). Edhe gjatë 2015-ës, ishim kompania më e besuar e sigurimeve dhe lider të tregut në Shqipëri dhe Kosovë si dhe përforcuam ndjeshëm pozitat në Maqedoni.

Ne jemi krenarë, që edhe pse tregu i sigurimeve në rajon orientohet kryesisht nga sigurimi i detyrueshëm motorik, SIGAL UNIQA është e vetmja kompani që mbi 50% të volumit të primeve i përfiton pikërisht nga sigurimet vullnetare. Në këtë segment, në Shqipëri në veçanti por edhe më gjerë në rajon, ka një potencial shumë të madh ende të pashfrytëzuar dhe kjo na bën optimistë për të ardhmen.

Viti 2015 ishte një vit historik për partnerin tonë, UNIQA Insurance Group, një prej grupeve financiare më të fuqishme në Europë. UNIQA arriti 6.3 miliardë Euro prime bruto, shifër kjo më e madhja e arritur ndonjëherë përgjatë gjithë viteve të ushtrimit të aktivitetit të saj. Partneriteti i suksesshëm me UNIQA u përforcua edhe më shumë gjatë 2015-ën kur UNIQA rriti prezencën e saj në SIGAL me 87% të aksioneve. Ne jemi të lumtur që një investitor si UNIQA Insurance Group na besoi ne dhe përmes SIGAL UNIQA është një prej investitorëve strategjikë dhe një mbështetje tejet e madhe financiare për ekonomitë e të tre shteteve, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe më gjerë për të gjithë rajonin.

Sporti, arti dhe kultura janë elementë tejet të rëndësishëm të identitetit kombëtar. Atë që nuk e bën dot politika apo diplomacitë e shteteve e bëjnë këta tre komponentë, ata

“Klientët janë kryefjala jonë, ndaj rritja e cilësisë së shërbimit për të përmbushur pritshmëritë e tyre është detyrimi ynë.”

bashkojnë kombet dhe kulturat. Ndaj ne jemi të lumtur që përgjatë 2015-ës këtyre zërave u kemi dhënë mbështetje që të bëhen më të fortë e të dëgjohen përtej kufijve, dhe bashkë me to të dëgjohet edhe emri i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA. Jam sidomos i kënaqur që një prej eventeve më të rëndësishme sportive në rajon, Liga Ballkanike e Basketbollit që prej vitit 2015 mban emrin e SIGAL UNIQA falë marrëveshjes 3-vjeçare të partneritetit.

Zhvillimi i teknologjisë, si çdo fushë tjetër ka prekurdhendikuar dhe industrinë e sigurimeve. Duke qenë vizionarë dhe duke dashur ti paraprijmë kohës, përgjatë vitit 2015 i kushtuam një rëndësi të veçantë përgatitjes për zhvillimin e teknologjisë brenda kompanisë. Punuam fort për të zhvilluar rrjetin e për të bërë të mundur që për herë të parë në Shqipëri ti ofrojmë publikut shitjen e produkteve të sigurimit online, si dhe përmirësimin e shërbimit online dhe lehtësimin në marrjen e informacionit. Këto zhvillime do të implementohen përgjatë vitit 2016, dhe jemi veçanërisht të lumtur që jemi të parët dhe të vetmit që ofrojmë këtë shërbim inovator.

Për shërbimin shumë të mirë ndaj klientëve dhe përgjigjes së tyre në kohë, jemi vlerësuar vazhdimisht nga organizma prestigjiozë ndërkombëtarë me çmime të ndryshme, ndër të tjera si “Sipërmarrja më e mirë”, “Kompania më e mirë në fushën e Sigurimeve në Shqipëri”,

“Një ndër kompanitë më të mira në rajon” etj., vlerësime të cilat na bëjnë krenarë dhe na stimulojnë akoma më shumë në punën tonë. Natyrisht që pas gjithë kësaj punë kolosale të SIGAL UNIQA qëndron nga mbrapa një staf i përkushtuar, të cilët nën emrin e SIGAL UNIQA i falënderoj përzemërisht dhe i inkurajoj që të vazhdojmë së bashku drejt rrugës së suksesit. Të tjera sfida na presin përgjatë vitit 2016. Objektivat tona janë të qarta jo vetëm për 2016-ën por edhe në terma afatgjatë. Pozicionin tonë si lider të tregut jo vetëm që do ta mbajmë krenarisht, por edhe do të vazhdojmë të rritemi e të përforcohemi, me theksin tek sigurimet vullnetare si një segment me potencialin më të madh në rajonin tonë.

Ne qëndrojmë mendjehapur përballë ndryshimeve që na dikton koha, duke ndërtuar strategji sipas kërkesave të tregut dhe nevojave të klientëve. Klientët janë kryefjala jonë, ndaj rritja e cilësisë së shërbimit për të përmbushur pritshmëritë e tyre është detyrimi ynë.

Mirënjohje dhe falënderime të sinqerta për secilin prej Jush!

Miqësisht,
Avni PONARI
Drejtor i Përgjithshëm
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Mendo të ardhmen dixhitale



616 milionë

përdorues interneti aktivë në Europë

3.4 bilionë

Përdorues smartphone në gjithë botën
(rritja vjetore 10%)

393 milionë

Ilogari aktive në media sociale në Europe



Më shumë se

1 milion

kërkime në ditë për sigurimet në internet



Tregu i **shitjes Online** në Europë është dyfishuar me

7.6%

nga 2008 deri në 2012.

Numri i **blerësve Online** në të gjithë botën do të dyfishohet nga 2011 deri në 2017

+100%

(2016: 1.3 bilionë)

Një eksperiencë pozitive në internet motivon persona në të gjithë botën të pëlqejnë dhe të blejnë produkte:

47-48%

do të rekomandonin kompaninë e tyre të sigurimit të tjerëve;

40%

do të blenin më shumë produkte nga kompania e sigurimit

Interneti është burimi i preferuar për të marrë informacion për shërbimet financiare rreth

60%

në vendet e zhvilluara në Azi dhe;

55%

në Europë

Përdorimi i **pajisjeve inteligjente** mund

të ulë risqet e sigurimeve me

40-60%

(për sigurimet e pronës)

15-25%

(për sigurimet motorike)

Rritja globale e trafikut të të dhënave për pajisje
(rritja mesatare për 2015-2021)

Smartphone:

50%

Tablet:

35%

Laptop:

20%

Të dhënat për Shqipërinë (Raporti 2015 i AKEP)

Numri i përdoruesve celularë:

3.4 milionë

Numri i përdoruesve të internetit nga telefoni: 1.4 milionë

rritja 49%



Penetrimi i internetit nga celulari:

46%

Numri i përdoruesve të internetit fiks:


243,000

(rritja 17%)

Penetrimi i internetit fiks:

9%

VLERAT DHE PARIMET TONA



Ne frymëzojmë

Ne jemi të përkushtuar ndaj klientëve dhe partnerëve tanë. Ne interesohemi për klientët dhe jemi të devotshëm ndaj klientëve. Ne kemi predispozitën ti njohim ata nga afër, të kuptojmë nevojat e tyre dhe ti frymëzojmë ata. Si një grup solid ne gjithmonë përpiqemi që të mbështesim dhe motivojmë kolegët tanë.

Ne formësojmë

Ne zhvillohemi vazhdimisht. Jemi aktivë, të hapur për ide të reja dhe për të implementuar standarte të reja në sektorin e sigurimeve me zgjidhje të reja inteligjente. Si skuadër ne i zhvillojmë fuqitë tona dhe jemi gjithmonë të gatshëm për të mësuar dhe për tu rritur profesionalisht.

Ne jemi të hapur

Ne jemi të ndershëm dhe të drejtpërdrejtë. Veprimet tona brenda kompanisë si dhe me palët e tjera janë të hapura dhe transparente. Ne u besojmë klientëve tanë dhe kolegëve, ndaj dhe shërbimi që ofrojmë është i besueshëm. Nuk ka asnjë axhendë të fshehur, gjithçka është transparente.

Ne servirim

Ne duam të jemi të suksesshëm. Si SIGAL UNIQA, qëllimi ynë kryesor është që të jemi gjithmonë të parët, gjithmonë lider të tregut. Ne jemi të suksesshëm sepse u ofrojmë klientëve tanë shërbimin më të mirë dhe të pakrahasueshëm. Ne gjithmonë i mbajmë premtimet ndaj klientëve dhe ndaj njëri-tjetrit.

AKSIONERËT TANË

Pjesë e UNIQA Insurance Group

Që prej Shtatorit 2015 UNIQA Insurance Group ka përforcuar prezencën e saj dhe zotëron 86.93% të aksioneve të kompanisë. UNIQA është një prej grupeve lider të sigurimit në Europë, me shtrirje në 19 shtete dhe numëron 40 kompani sigurimi si pjesë të grupit në të cilin punojnë 22,000 punonjës dhe agjentë.

Referuar të dhënave për vitin 2015, volumi i primeve të shkruara të UNIQA arriti në 6 miliardë Euro; 423 milionë Euro fitime dhe 27 miliardë Euro asete nën menaxhim.


Me një histori 150-vjeçare në fushën e sigurimeve, UNIQA Insurance Group operon në 19 shtete të Europës Qendrore-Lindore dhe ka fituar besimin e mbi 10 milionë klientëve në të gjitha shtetet ku ushtron aktivitetin e saj. Si një prej aktorëve kryesorë të financave europiane, UNIQA është vlerësuar në vijimësi me 'A' nga 'Standard&Poor's'.

Fondi Amerikan


Në vitin 2003 Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (FSHAN) bleu 13.3% të aksioneve të SIGAL duke bërë investitori i parë i huaj që hyri në tregun shqiptar të sigurimeve.

FSHAN është një organizatë amerikane jofitimprurëse, jopolitike, e themeluar në pajtim me Aktin e vitit 1989 mbi Ndihmën për Demokracinë në Evropën Lindore (SEED Act). Qëllimi i tij kryesor është nxitja e zhvillimit të sektorit privat në Shqipëri. Ndaj, me përbushjen e misionit të tij tek SIGAL UNIQA, duke ndikuar në rritjen dhe maturimin e saj përgjatë 12 viteve bashkëpunim, që prej shtatorit të vitit 2015, FSHAN ia kaloi të gjitha aksionet kompanisë mëmë, SIGAL UNIQA.

FSHAN është themeluar në vitin 1995 dhe ka zyra në Nju Jork dhe Tiranë. Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka dhënë 30 milionë dollarë si kapital fillestar përmes një granti nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Arritjet dhe profili i Fondit kanë shkuar përtej burimeve modeste financiare të fillimit. Me një bazë kapitali prej 30 milionë dollarësh, FSHAN ka kryer investime të drejtpërdrejta në masën 110 milionë dollarë në 77 investime në 40 shoqëri.



Struktura aksionere deri në Shtator 2015



Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA Group Austria



Andreas Brandstetter
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës,
Drejtor i Përgjithshëm i UNIQA Insurance Group



Wolfgang Kindl,
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
Drejtor i Përgjithshëm i UNIQA International



Gerald Mueller,
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
UNIQA Insurance Group



Martin Mata,
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,
Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve



Dr. Erhard Busek,
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës

NGJARJE TË RËNDËSISHME



Samiti për Naftën, Gazin dhe Energjinë

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA pjesë e Samitit për Naftën, Gazin dhe Energjinë

SIGAL UNIQA ishte ndër partnerët kryesorë të Samitit për Naftën, Gazin dhe Energjinë që u zhvillua për herë të parë në Shqipëri. Ky event, me një rëndësi të veçantë për promovimin e ekonomisë shqiptare përmes tërheqjes së investitorëve të huaj, solli në Shqipëri kompanitë më të mëdha të energjisë, gazit dhe hidrokarbureve. Si kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe pjesë e UNIQA Insurance Group, një prej grupeve më të mëdha financiare në Europë, SIGAL UNIQA u prezantua si një partner kyç për të gjitha kompanitë pjesëmarrëse në Samit, veçanërisht për investitorët e huaj strategjikë. SIGAL UNIQA u bë pjesë e diskutimeve mbi investimet dhe strategjitë lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të sektorit energjistik në vend. Aktualisht, mbi 70% e portofolit të SIGAL UNIQA gjenerohet nga korporata dhe insitucione të rëndësishme, private dhe publike, të cilat po implementojnë në Shqipëri projekte afatgjata të një rëndësie jetike për zhvillimin ekonomik të vendit.



Liga Ballkanike e Basketbollit nën emrin e SIGAL UNIQA

Liga Ballkanike e Basketbollit (BIKL) që nga tetori i 2015-ës ka marrë emrin "SIGAL UNIQA Balkan League". Marrëveshja 3-vjeçare u firmos nga Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA z. Avni Ponari dhe Drejtori i BIBL, z. Shay Shtriks.

"BIKL, tashmë 'SIGAL UNIQA Balkan League', është krenare që një kompani me një reputacion të tillë si SIGAL UNIQA Group pranoi që të bashkëpunonte me projektin tonë për Ballkanin dhe të na jepte mundësinë që të kemi emrin e tyre për tre vitet e ardhshme. Kjo tregon që edhe pse Ballkan League është e pranishme vetëm në Ballkan, falë një organizimi të mirë të zhvillimit të sporteve me benefite për komunitetet lokale, ne fituam besimin e një emri tepër të njohur siç është SIGAL UNIQA Group AUSTRIA", -thuhet në njoftimin për shtyp të SIGAL UNIQA Balkan League.



SIGAL Prishtina shpallet kampione e Ligës Ballkanike të Basketbollit

Ekspozita UNIQ'Art

Në dhjetor 2015, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA inauguroi ekspozitën "UNIQ'Art" me pjesëmarrjen e përfaqësuesve diplomatikë, përfaqësuesë nga media, arti dhe kultura në vend. 28 karikatura të punuara nga profesor Bujar Kapexhiu (Mjeshtër i Madh) dhe Orlis Vathi iu ekspozuan publikut për disa ditë me radhë. Karikaturat, të punuara enkas për kompaninë më të madhe të sigurimeve në vend, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, përmes artit, shprehnin rëndësinë e produkteve të sigurimit, si një kulturë që duhet zhvilluar në vendin tonë dhe për më tepër si një domosdoshmëri e kohës.

Pas Tiranës, ekspozita u realizua gjithashtu në Klubin e Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA në Durrës, ku morën pjesë dhjetëra artistë e artdashës të qytetit të Durrësit. Në vijimësi, ekspozita do të prezantohet gjithashtu në shumë qytete të Kosovës dhe Maqedonisë, duke filluar më Prishtinën dhe Shkupin.

Takimi informues me mediat 'Të flasim për sigurimet'

Për herë të parë në Shqipëri u organizua një takim informues me përfaqësuesë të medias, për të folur mbi zhvillimin dhe sfidat e tregut të sigurimeve në vend si dhe nevojën e një mediaje të informuar. Takimi u organizua nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të medias, gazetarë dhe moderatorë nga të gjitha mediat audio-vizive dhe asaj të printuar, për të folur për tregun e sigurimeve në Shqipëri, sfidat dhe potencialet e zhvillimit të këtij tregu.

Drejtori i Përgjithshëm i Sigal Uniqa, z. Avni Ponari, përgjatë bashkëbisedimit me gazetarët, vuri theksin tek nevoja e një mediaje të informuar për tregun e sigurimeve si dhe mbi domosdoshmërinë që media duhet të luajë për informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për t'u siguruar, pasi sigurimet janë një domosdoshmëri dhe jo luks. Në takim u diskutua edhe për metodat se si mund të ndryshohet trendi i sigurimeve, pasi aktualisht në Shqipëri 60% e tregut



Ekspozita e UNIQ'Art



Ekspozita e UNIQ'Art



Takimi informues per mediat



Startup Grind Albania



Startup Grind Albania

të sigurimeve përbëhet nga sigurimi i detyrueshëm motorik, duke lënë në plan të dytë rëndësinë e sigurimit të jetës, shëndetit, pasurisë, biznesit etj, kur në fakt duhet të ndodhë e kundërta. Lajmi mbi takimin u pasqyrua gjerësisht në median e shkruar, të cilat vlerësuan rëndësinë e organizimit të takimeve të tilla dhe komunikimit më të shpeshtë e të hapur midis institucioneve të tilla financiare dhe medias.

SIGAL UNIQA mbështet sipërmarrjen 'Startup Grind Albania'

Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari takoi dhjetëra të rinj sipërmarrës në aktivitetin "Startup Grind Tirana", një projekt i mbështetur nga "Google for Entrepreneurs" i shtrirë në 70 vende të botës, i cili ka për qëllim të mbështesë dhe nxisë sipërmarrësit e rinj. Gjatë takimit z. Ponari foli për eksperiencën e tij në krijimin e një kompanie të tillë si SIGAL UNIQA si dhe për sfidat dhe problemet e tregut. Në fund të takimit, një pjesë e të pranishmëve biseduan personalisht me Drejtorin e SIGAL UNIQA, duke i shpjeguar idetë e bizneseve që mendojnë të krijojnë dhe i kërkuan atij këshilla se si mund ti zhvillojnë iniciativat e tyre. Ponari u shpreh i hapur për ti ndihmuar sipërmarrësit e rinj në rrugën e tyre të biznesit.

SIGAL UNIQA vlerësohet nga Qeveria Shqiptare për kontributin në kulturë

Në dhjetor 2015 SIGAL UNIQA u nominua nga Qeveria Shqiptare në eventin gala të sipërmarrësve më të mirë, "Bleta e Artë 2015", për çmimin "Sipërmarrje në Kulturë", si një nga katër kompanitë më të mira, e cila ka mbështetur artin dhe kulturën në vend. E organizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, mbrëmja gala "Bleta e Artë 2015" vlerëson sipërmarrjet më të mira të vitit. Qëllimi i këtij eventi është promovimi i sipërmarrjes shqiptare dhe punës e kontributit të saj në zhvillimin ekonomik të vendit dhe punësimin. Gjatë mbrëmjes u nominuan 48 biznese në 12 kategori të ndryshme ndër të cilat, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA ishte një prej kompanive më të vlerësuara për rolin dhe kontributin e dhënë në sipërmarrje dhe projekte të ndryshme kulturore.



Nominuar për çmimin Bleta e Artë 2015

Vlerësime ndërkombëtare për SIGAL UNIQA

South East European News (SEE) një institucion që vlerëson performancën ekonomike të shteteve të Europës Jug-Lindore dhe kompanive që operojnë në këto shtete, ka vlerësuar SIGAL UNIQA Group AUSTRIA si një ndër kompanitë më të mira të sigurimeve në rajon edhe për vitin 2015. SIGAL UNIQA është kompania e vetme shqiptare që është në listën e 100 siguresve të mirë në rajon. Në listë analizohen rreth 2000 subjekte financiare dhe jo-financiare prej të cilave përzgjidhen vetëm 100 kompanitë më të mira.

Superbrand International, në bazë të një sondazhi të realizuar në tregun shqiptar të sigurimeve, në vitin 2015, e ka shpallur kompaninë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA si kompaninë më të mirë të sigurimeve në Shqipëri. Studimi është kryer për të vlerësuar kompanitë e mëdha që operojnë në Shqipëri, duke konsideruar elementë si: prezenca në treg, qëndrueshmëria, produktet e ofruara, vlerësimi dhe besnikëria e klientëve. Rezultatet e studimit vërtetuan se SIGAL UNIQA është kompania më e vlerësuar e sigurimeve në të gjithë treguesit.

Asambleja e Biznesit European (Europe Business Assembly) me qendër në Londër, i ka akorduar SIGAL UNIQA Group AUSTRIA çmimin "Sipërmarrja më e mirë" dhe "Sipërmarrja më e mirë në fushën e sigurimeve". Asambleja e Biznesit European i akordon çmimet në bazë të plotësimit të disa kriterëve strikte siç janë: Pozicioni i fortë në tregun kombëtar, statusi i kompanisë dhe renditja ndërkombëtare, teknologji moderne në menaxhim, kualifikimi i lartë i stafit, reputacioni i biznesit, strategjia e sukseshme e marketingut, imazhi pozitiv në rajon, renditja e investimeve dhe atraksioneve si dhe konkurrenca.

Gjithashtu, shumë institucione të tjera kanë renditur SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA si Kompaninë më të Mirë të Sigurimeve në Shqipëri ndër të cilat: Global Banking and Financial Review, European Society for Quality Research; Capital Finance International; Magazine Top International Business; Icertias; Qudal International.



Sipërmarrja më e mirë

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Promovojmë Shqipërinë

Folklori dhe trashëgimia jonë kulturore janë pjesë e rëndësishme e identitetit tonë kombëtar, ndaj krahas kontributit që ka dhënë Klubi i Artit SIGAL UNIQA, kemi mbështetur Festivalin Mbarëkombëtar Folklorik të Gjirokastrës "Argjiro Fest-On". Jemi të lumtur që mbështesim një event të tillë, ku marrin pjesë artistë të shkëlqyer dhe ku promovohen vlerat e artit tonë. Në përputhje me këtë filozofi, Festivali Operistik Marije Kraja është një tjetër aktivitet i rëndësishëm që kemi mbështetur, i cili sjell në Shqipëri emra të njohur të skenës ndërkombëtare. Një tjetër aktivitetet i këtyre përmasave i zhvilluar në Shqipëri dhe i mbështetur nga SIGAL UNIQA është "Takimi Muzikor i Dy Botëve", i cili bashkon zërat dhe tingujt e artistëve të huaj e shqiptarë në disa prej atraksioneve historike të vendit tonë.

Krahas projekteve kulturore, në 2015-ën promovuam Shqipërinë duke qenë ndër mbështetësit kryesorë të pavionit shqiptar në Milan Expo 2015.

Me ftesë të SIGAL UNIQA vizitoi për herë të parë Shqipërinë Klubi Rotarian Austriak, i cili përbëhet nga investitorë e binzesmenë të rëndësishëm austriakë. Për disa ditë me radhë pjesëtarët e Klubit Rotarian Austriak eksploruan bukuritë natyrore dhe trashëgiminë e pasur kulturore të vendit tonë.

Sigurimi përmes artit

I themeluar që nga viti 2010, çdo javë, Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL mirëpret mesatarisht 3 aktivitete artistike, duke u shndërruar në vendin ideal për të gjithë dashamirësit e letërsisë, muzikës dhe arteve pamore. Emrat e artistëve dhe aktivitetet e shumta të zhvilluara, edhe përgjatë 2015-ës, janë një provë e rolit të Klubit në promovimin e artit dhe kulturës bashkëkohore shqiptare, përmes prezantimeve të titujve të rinj letrarë, eventeve muzikore, ekspozitave të pikturës, skulpturës etj. Në



Vizita e klubit Rotarian Austriak, në Drimadhes



Vizita e klubit Rotarian Austriak, në Butrint



Klubi i Artit dhe Kulturës, Durrës





Klinika Lëvizëse SIGAL UNIQA
në Valbonë



Klinika Lëvizëse SIGAL UNIQA
në Vermosh



këtë mënyrë, Klubi i Artit dhe Kulturës ka kontribuar në edukimin e mëtejshëm të publikut të gjerë me risitë kulturore në Durrës dhe në të gjithë Shqipërinë.

Promovojmë shëndetin e mirë!

Është më mirë të parandalosh një sëmundje sesa ta kurosh atë! Nisur nga kjo filozofi, në vitin 2015 SIGAL UNIQA Group AUSTRIA erdhi me një risi të re në fushën e shëndetit: ndërtoi Klinikën Lëvizëse SIGAL UNIQA. E para dhe e vetmja e këtij lloji në Shqipëri, klinika lëvizëse ofron shërbime shëndetësore falas për klientët dhe qytetarët. Klinika u promovua në skajin verior të Shqipërisë, në Valbonë për te vijuar më pas në Vermosh e Berat ku banorëve të zonës iu mundësuan një shumëllojshmëri ekzaminimesh, duke filluar që nga vizitat, echot, matje sheqeri, vizitë ORL etj. E konceptuar si një klinikë që ofron shërbimet bazë diagnostikuese, klinika lëvizëse do të jetë në çdo cep të Shqipërisë, duke sensibilizuar qytetarët për kujdesin ndaj shëndetit.

Në kuadër të promovimit shëndetësor, kemi hapur Klubin e Shëndetit VitalClub, ku marrin trajtime fizioterapeutike qindra klientë të SIGAL UNIQA.

Mbështesim talentin e artistëve shqiptarë!

Ne ndjehemi krenarë për artistët e shumtë shqiptarë që kanë ngritur lart vlera e kombit tonë në arenën ndërkombëtare. Me kënaqësi ishim prezentë si mbështetës të Koncertit Simfonik, me pjesëmarrjen e Shkëlzen Dolit-pjesëtar i Filarmonisë së Vjenës dhe njëherësh autorit të 'Shpirti Shqiptar', e cila hapi siparin e Koncertit të Vjenës në fillim-vitin 2015.

"Different Trains Festival", një risi e bukur e jetës artistike në Shqipëri, është një tjetër event artistik, i mbështetur që prej disa vjetësh nga SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA dhe natyrisht edhe përgjatë 2015-ës nuk i mungoi mbështetja jonë.

Gjatë këtij viti, më kënaqësi mbështetëm koncertin 'Tre tenorët nga Kosova' e cilësuar nga mediat si një ndër shfaqjet më të rëndësishme të muzikës lirike në vend.

SKUADRA SIGAL UNIQA



Takimi vjetor rajonal, 2015

Në skuadrën e SIGAL UNIQA bëjnë pjesë rreth 1200 punonjës dhe agjentë. Kohëzgjatja mesatare e punonjësve në SIGAL UNIQA është 7 vjet, fakt që dëshmon se ne investojmë tek punonjësit tanë, i përgatisim dhe i rrisim profesionalisht.

Punonjësit e SIGAL UNIQA trajnohen vazhdimisht nga stafi drejtues i SIGAL UNIQA në Tiranë si dhe nga drejtuesit dhe manaxherët më të mirë të UNIQA International.

Takimet dhe workshop-et në vende të ndryshme (19 shtete ku operon UNIQA) që zhvillohen disa herë në vit janë një mundësi shumë e mirë dhe një shkëmbim eksperiencash dhe kulturash për punonjësit tanë.

SIGAL UNIQA i nxit dhe i mbështet punonjësit e saj për të marrë pjesë në kurse apo studime pasuniversitare, në mënyrë që niveli i tyre akademik dhe profesional të mos ndalet por të zhvillohet gjithmonë e më tepër.

Një staf i kualifikuar do të thotë punë më e mirë, rezultate më të larta dhe sukses individual e rrjedhimisht sukses edhe për kompaninë.



Fushata 'Mendo SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA'

Mesazhi 'Mendo të guxosh për lumturinë tënde'

Fushata 'Mendo' e prezantuar plotësisht në muajt e parë të 2015-ës ka vijuar suksesshëm përgjatë gjithë vitit. Në dallim nga fushatat dhe sloganet e mëparshme, fushata 'Mendo' paraqet një filozofi të re, një mënyrë të jetuari dhe menduari të orientuar nga pozitiviteti dhe lumturia. 'Mendo SIGAL UNIQA' nuk është një taktike shitjeje sesa një qëndrim. 'Mendo' përcjell idenë e të qenit bashkë si një familje, është një këndvështrim aktiv dhe aspak pasiv apo negativ.

Përmes fushatës së re, ne duam të inkurajojmë njerëzit që të ndërtojnë jetën e tyre, të minimizojë frikën, të përballojnë problemet dhe të gjejnë lumturinë në jetë.

Gjithashtu, duam ti nxisim ata që të marin përsipër rreziqe të vogla, të kapërcejnë kufijtë personalë, të përqafojnë një perspektivë të re, të jenë optimist. Përmes të gjitha këtyre, secili prej nesh do të ketë më shumë lumturi në jetë duke guxuar më shumë për të.

Mesazhi 'Mendo SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA'

Slogani 'Mendo SIGAL UNIQA' i ndihmon klientët të mendojnë e të veprojnë ndryshe si dhe ti shohin situatat nën një këndvështrim të ri. SIGAL UNIQA dëshiron që tu përcjellë këtë ide jo vetëm klientëve të saj por të gjithë audiencës. Duke pasur parasysh se shpesh njerëzit përballen krejt të vetëm me frikën dhe pasiguritë e tyre, ndaj SIGAL UNIQA dëshiron që përmes këtij slogani të ri të pozicionohet si një kompani që ofron besim dhe siguri jo vetëm përmes produkteve të sigurimit por mbi të gjitha si një partner afatgjatë dhe shoqëruar për një jetë më të mirë.

Me këtë synim, në strategjinë tonë të komunikimit kemi përfshirë krahas shprehjeve si 'Mendo e ardhmja të perket ty', 'Mendo ndonjëherë fiton, ndonjëherë mëson', 'Mendo familja është vendi më i sigurt në botë', 'Mendo çfarë të bën të lumtur?', 'Mendo një ditë e re është një mundësi e re' dhe shumë shprehje e pyetje të tjera të cilat i përdorim shpesh në komunikimin tonë të përditshëm dhe si të tilla janë pjesë e shprehive tona në familje, punë apo mes miqsh. Në këtë mënyrë, 'Mendo' po bëhet gradualisht pjesë e bisedave të çdokujt.

Një pjesë kyçe e fushatës 'Mendo' është përbrendësimi i saj veçanërisht nga stafi i SIGAL UNIQA. Mendo SIGAL UNIQA do të thotë që perceptimi ynë për shërbimin ndaj klientit është i njëjtë nëse do ti shërbenim të afërmeve tanë. Me këtë qëndrim, synimi ynë është shërbim një shërbim të besueshëm dhe të ndërhëm, ti mbështesim klientët dhe ti trajtojmë ata me respekt.

Mendo SIGAL UNIQA do të thotë gjithashtu t'i tejkalojmë pritshmëritë e klientëve tanë. Ne u tregojmë klientëve tanë një përkushtim që shkon përtej standardeve dhe ky është qëllimi i performancës sonë.

Ne jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi ndaj klientëve tanë çka do të thotë që ne japim premtime që mund ti mbajmë dhe ofrojmë produkte për të cilat përgjigjemi plotësisht.






SIGAL UNIQA Group Austria, Shkup, Maqedoni

TË DHËNA FINANCIARE


Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)



Kompania	2012 (në Euro)	2013 (në Euro)	2014 (në Euro)	2015 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	17,598,129	18,920,508	21,976,027	26,826,453
SIGAL Life UNIQA AL	3,228,050	4,136,826	4,724,770	4,821,793
SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA	961,625	1,442,152	788,946	1,269,642
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	9,222,743	10,912,741	12,390,804	12,482,576
SIGAL Life UNIQA KS	188,126	238,858	338,738	910,595
UNIQA MK Jo-Jetë	8,041,964	10,371,295	10,216,259	11,063,068
UNIQA Life MK	672,530	669,719	760,249	961,656
GRUPI	39,913,167	46,692,100	51,195,794	58,335,782

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2015



Lloji i Produktit	AL (në Euro)	KS (në Euro)	MK (në Euro)	Grupi (në Euro)
Pasuri	9,155,129	2,142,478	2,467,385	13,764,991
M. Motorike	14,586,135	7,028,581	7,710,712	29,325,428
Jetë, Shëndet dhe Aksidente	7,814,601	4,222,112	1,846,627	13,883,339
Pensione Vullnetare*	1,269,642	-	-	1,269,642
Risigurime*	92,382	-	-	92,382
TOTALI	32,917,888	13,393,170	12,024,724	58,335,782


* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA.

TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON

Tregu shqiptar i sigurimeve jo-jetë


Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 8 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 28.71% të tregut.

SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 27.65% të dëmeve.




Tregu shqiptar i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2015 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 65.81% e cila ka paguar 35.07% të dëmeve të ndodhura në treg.




Tregu shqiptar i pensioneve private

Gjatë vitit 2015, në tregun e pensioneve operuan 3 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për vlerën e aseteve neto (50.44%) ashtu edhe për numrin e kuotave.




Tregu kosovar i sigurimeve

Në tregun kosovar operojnë 12 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e para me 15.86% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 17.29% të dëmeve totale të tregut.




Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e dyta me 33.46% të tregut për volumin e primeve dhe ka paguar 19.79% të dëmeve.




Tregu maqedonas i sigurimeve

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 11 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e gjashta për nga volumi i primeve të shkruara (9.48%) dhe ka paguar 9.47% të dëmeve.



UNIQA Life renditet e katërta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (5.37%) në të cilin operojnë 4 kompani dhe ka paguar 2.28% të dëmeve.



TË DHËNA KRYESORE / FINANCIAL DATA

Volumi i primeve
Premium volume (Euro)
2015

Group	58,335,782
AL	32,917,888
KS	13,393,170
MK	12,024,724

Volumi i primeve
Premium volume (Euro)
2014

Group	51,195,794
AL	27,489,743
KS	12,729,543
MK	10,976,508

2015/2014 për Grupin
Group 2015/2014 (%)

rritur
increased
13.95
%

Nr. kontratash
No. of contracts 2015

Group	764,991
AL	256,264
KS	133,708
MK	375,019

Nr. kontratash
No. of contracts 2014

Group	674,286
AL	236,214
KS	113,565
MK	324,507

2015/2014 për Grupin
Group 2015/2014 (%)

rritur
increased
13.45
%

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.
Pasqyrat Financiare te Konsoliduara
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(me raportin e aUdituesit te pavarur bashkelidhur)

*Consolidated Financial Statements
as at and for the year ended 31 December 2015
(with the independent auditor's report thereon)*

Dëme të paguara
Paid claims (Euro)
2015

Group	
AL	
KS	
MK	

Dëme të paguara
Paid claims (Euro)
2014

Group	18,436,920
AL	6,925,731
KS	6,805,962
MK	4,705,227

2015/2014 për Grupin
Group 2015/2014 (%)

rritur
increased
32.01
%

Nr. dëmsh të paguara
No. of Paid claims 2015

Group	82,015
AL	14,952
KS	63,076
MK	3,987

Nr. dëmsh të paguara
No. of Paid claims 2014

Group	50,281
AL	14,867
KS	31,883
MK	3,531

2015/2014 për Grupin
Group 2015/2014 (%)

rritur
increased
63.11
%

Objektivat Forecast 2016

Volumi primeve
Premium volume 2016 (Euro)

Group	63,423,634
AL	36,864,724
KS	13,150,000
MK	13,408,910

RAPORTI I PAVARUR I AUDITIT

Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të SIGAL UNIQA Group Austria sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur të SIGAL UNIQA Group Austria sh.a. dhe filialeve të saj ("grupi") të cilat përbëhen nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015 dhe pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ndryshimet në kapital dhe flukset e parasë për vitin ushtrimor të mbyllur më këtë datë si dhe nga një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacion tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe shënimeve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të grupit me 31 dhjetor 2015, si dhe të performancës financiare dhe të flukseve të parasë për vitin ushtrimor e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

Jonid Lamllari
Auditues Ligjor

22 qershor 2016
Tiranë, Shqipëri



INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

To the Shareholders and Board of Directors of SIGAL UNIQA Group Austria sh.a.

We have audited the accompanying consolidated financial statements of SIGAL UNIQA Group Austria sh.a. and its subsidiaries (the "Group"), which comprise the consolidated statement of financial position as at 31 December 2015 and the consolidated statements of profit or loss and other comprehensive income, changes in equity and cash flows for the year then ended, and notes comprising a summary of significant accounting policies and other explanatory information.

Management's Responsibility for the Consolidated Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these consolidated financial statements in accordance with International Financial Reporting Standards, and for such internal control as management determines is necessary to enable the preparation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error.

Auditor's Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these consolidated financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the consolidated financial statements are free from material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the consolidated financial statements. The procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the consolidated financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the consolidated financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the consolidated financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.


Opinion

In our opinion, the consolidated financial statements present fairly, in all material respects, the financial position of the Group as at 31 December 2015, and its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with International Financial Reporting Standards.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

Jonid Lamllari
Statutory Auditor

22 June 2016
Tirana, Albania



Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014	1 janar 2014 rishikuar
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	10 468,977	526,862	427,494
Depozita me afat	11 6,508,551	5,957,626	5,369,719
Investime në letra me vlerë	12 1,852,479	1,367,895	946,700
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të arkëtueshme të tjera	13 1,080,616	934,793	922,618
Aktive të risigurimit	14 715,354	629,690	697,074
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim	15 881,432	758,001	505,726
Inventari	2,774	6,338	5,357
Tatim fitimi i arkëtueshëm	5,237	4,355	12,538
Aktive afatgjata materiale	16 1,346,866	1,426,884	1,279,298
Aktive të tjera	17 255,615	202,092	204,332
TOTALI AKTIVEVE	13,117,901	11,814,536	10,370,856
DETYRIMET			
Rezerva teknike të dëmeve	18 3,653,407	3,092,731	2,844,862
Rezerva për primet e pafituara	18 3,794,703	3,500,423	3,025,198
Rezerva të tjera	18 853,163	705,657	402,898
Detyrime të tatimit mbi fitimin	34,636	22,447	-
Detyrime nga sigurimet dhe risigurimet	19 481,762	309,029	291,349
Tatim fitimi i pagueshëm	20 101,115	97,325	-
Detyrime të tjera	20 185,930	219,378	177,341
TOTALI I DETYRIMEVE	9,104,716	7,946,990	6,741,648
KAPITALI			
Kapitali themeltar	21 2,232,909	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit	22 52,133	52,133	52,133
Rezerva të rrezikut të sigurimit	22 545,761	530,008	466,519
Rezerva e përkthimit	51,878	98,002	112,776
Fitime të mbajtura	1,121,791	946,359	755,849
Totali i kapitalit që i atribuohet pronarëve të Shoqërisë Mëmë	4,004,472	3,859,393	3,620,186
Interesi jo-kontrollues	8,713	8,153	9,022
TOTALI I KAPITALIT	4,013,185	3,894,281	3,629,208
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE	13,117,901	11,814,536	10,370,856

Shënimet nga faqja 5 ne 40 janë pjesa integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë aprovuar nga Drejtuesit e Grupit më 13 qershor 2016 dhe janë firmosur nga:

Avni Ponari
Drejtor i Përgjithshëm



Klement Mersini
Drejtor Finance



Consolidated statement of financial position

as at 31 December 2015

(All amounts are expressed in thousand Lek, unless otherwise stated)

Notes	31 December 2015	31 December 2014	1 January 2014 restated
ASSETS			
Cash and cash equivalents	10 468,977	526,862	427,494
Term deposits	11 6,508,551	5,957,626	5,369,719
Investments in securities	12 1,852,479	1,367,895	946,700
Insurance and other receivables	13 1,080,616	934,793	922,618
Reinsurance assets	14 715,354	629,690	697,074
Deferred acquisition costs	15 881,432	758,001	505,726
Inventory	2,774	6,338	5,357
Corporate income tax receivable	5,237	4,355	12,538
Property and equipment	16 1,346,866	1,426,884	1,279,298
Other assets	17 255,615	202,092	204,332
TOTAL ASSETS	13,117,901	11,814,536	10,370,856
LIABILITIES			
Liabilities for losses and loss adjustment expenses	18 3,653,407	3,092,731	2,844,862
Unearned premium reserve	18 3,794,703	3,500,423	3,025,198
Other reserves	18 853,163	705,657	402,898
Income tax liability	34,636	22,447	-
Insurance and reinsurance payables	19 481,762	309,029	291,349
Provisions	20 101,115	97,325	-
Other payables	20 185,930	219,378	177,341
TOTAL LIABILITIES	9,104,716	7,946,990	6,741,648
EQUITY			
Ordinary shares	21 2,232,909	2,232,909	2,232,909
Other capital reserves	22 52,133	52,133	52,133
Insurance risk reserves	22 545,761	530,008	466,519
Translation reserves	51,878	98,002	112,776
Retained earnings	1,121,791	946,359	755,849
Total equity attributable to owners of the Parent	4,004,472	3,859,393	3,620,186
Non-controlling interest	8,713	8,153	9,022
TOTAL EQUITY	4,013,185	3,894,281	3,629,208
TOTAL EQUITY AND LIABILITIES	13,117,901	11,814,536	10,370,856


The notes on pages 5 to 44 are an integral part of these consolidated financial statements.

These consolidated financial statements have been approved by the Directors of the Group on 13 June 2016 and signed on their behalf by:

Avni Ponari
General Manager



Klement Mersini
Finance Manager



Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	2015	2014 rishikuar
Prime të shkruara bruto	23	7,981,248	7,052,954
Prime të ceduara risiguresve	24	(816,208)	(787,786)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		7,165,040	6,265,168
Ndryshimi në rezervën për prime të papërfituara	18	(330,276)	(450,640)
Ndryshimi në rezervën për prime të ceduara risiguresve	14	(57,554)	(26,903)
Të ardhura neto nga primet		6,777,210	5,787,625
Të ardhura nga investimet	25	153,753	180,917
Të ardhura të tjera	26	154,881	169,840
Të ardhura neto		7,085,844	6,138,382
Ndryshimi në rezerva të tjera	18	(147,506)	(318,221)
Ndryshimi në risigurime të mbledhshme	18	144,432	(16,971)
Dëme dhe shpenzime nga rregullimi i humbjeve	18	(3,103,397)	(2,170,546)
Dëme të sigurimit neto		(3,106,471)	(2,505,738)
Kostot e marrjes në sigurim	27	(1,331,072)	(896,619)
Shpenzime administrative dhe marketingu	28	(1,625,644)	(1,541,033)
Shpenzime të tjera sigurimi	29	(476,738)	(685,441)
Humbje nga kurset e këmbimit		63,756	119,203
Fitimi para tatimit		609,675	628,756
Tatimi mbi fitimin	30	(278,346)	(251,482)
Fitimi i vitit		331,329	393,148
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		444	15,874
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		331,773	393,148
Fitimi i atribueshëm për:			
Pronarët e Shoqërisë Mëmë		330,741	378,125
Interesi jo-kontrollues		588	(851)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të atribueshme për:			
Pronarët e Shoqërisë Mëmë		331,185	393,999
Interesi jo-kontrollues		588	(851)

Shënimet nga faqja 5 ne 40 janë pjesa integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Consolidated statement of profit or loss and other comprehensive income

for the year ended 31 December 2015

(All amounts are expressed in thousand Lek, unless otherwise stated)

	Note	2015	2014 restated
Premium revenue	23	7,981,248	7,052,954
Premium ceded to reinsurers	24	(816,208)	(787,786)
Net written premium		7,165,040	6,265,168
Change in provision for unearned premium	18	(330,276)	(450,640)
Change in provision for unearned premium ceded to reinsurers	14	(57,554)	(26,903)
Net earned premium		6,777,210	5,787,625
Investment income	25	153,753	180,917
Other income	26	154,881	169,840
Net income		7,085,844	6,138,382
Change in other reserve	18	(147,506)	(318,221)
Change in reinsurance recoverable	18	144,432	(16,971)
Insurance claims and loss adjustment expenses	18	(3,103,397)	(2,170,546)
